




SEMINARET NË IGJK



SEMINARET NË IGJK



Instituti Gjyqësor i Kosovës
Kosovski Institut za Pravosudje
Kosovo Judicial Institute

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Instituti Gjyqësor i Kosovës / Kosovski Institut za Pravosudje
Kosovo Judicial Institute



RRUGA "MUHARREM FEJZA" P. N.
PRISHTINË

INSTITUTI GJYQËSOR
I KOSOVËS

TEL: +381 38 512 069
+381 38 512 081
+381 38 512 095
FAX: +381 38 512 069 / 212
www.kjijudicial.org

ORGAN I PAVARUR PROFESJONAL DHE INSTITUCION KRYESOR
PËR AFTËSIMIN E GJITHË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE
BRENDA SISTEMIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

PRISHTINË/PRISTINA, KOSOVË- KOSOVO
2009

INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS ARSIMIM CILËSORË PËR SISTEMIN E DREJTËSISË

HYRJE

Brenda mandatit për ndërtimin e institucioneve, Misioni i OSBE-së në Kosovë në bazë të parimeve për të drejtat e njeriut dhe sundimit të ligjit ndihmoi Kosovën në zhvillimin e sistemit gjyqësor. Misioni i OSBE-së, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit themeloi sektorin për trajnime gjyqësore, i cili më vonë në shkurt të vitit 2000, u riemërua si Instituti Gjyqësor i Kosovës.

Më 24 prill 2006, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara nxjerri Ligjin për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës. Ky ligj u miratua nga Kuvendi i Kosovës në shkurt 2006, përmes të cilit IGJK u bë institucion i pavarur profesional dhe institucion kryesor për aftësim profesional brenda sistemit gjyqësor të Kosovës i cili duhet t'i përmbush funksionet e veta bazuar në parimet e ligjshmërisë, paanshmërisë dhe efikasitetit.

Selia e IGJK-së është në Prishtinë. Mandati i IGJK-së është të aftësoj bartësit e funksioneve në gjyqësi (gjyqtarët dhe prokurorët) dhe bartësit potencial të funksionit në gjyqësi. IGJK-ja promovon nivelin e arsimit profesional në bazë të nevojave të gjyqësorisë.

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK), në kuadër të aktiviteteve të veta mund të lidhë marrëveshje pune, bashkëpunimi dhe vepërimitarie shkencore, profesionale me institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare. Prandaj, në mënyrë që të arrihet të gjitha këto objektiva, IGJK ka nevojë të vazhdojë bashkëpunimin dhe koordinimin me të gjithë aktorët kryesorë të përfshirë në sistemin gjyqësor.

VIZIONI DHE MISIONI I IGJK-SË

Misioni i IGJK-së është që të krijoj në Kosovë një shërbim trajnimi profesional më bashkëkohorë për gjyqtarët dhe prokurorët, duke zbatuar teknikat më të avancuara, më të reja dhe më efektive të mësimdhënies, ashtu që të ofrojë cilësinë më të lartë të arsimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë. Kjo nënkupton që IGJK-ja do të trajnoj secilin gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë. Si pjesë e misionit të IGJK-së është gjithashtu krijimi i një shkolle më të avancuar të magjistraturës. Shtesë kësaj, vizioni i IGJK-së është të bëhet:

Udhëheqëse në zhvillimin e programeve trajnuese për sistemin gjyqësor dhe prokurorë të Kosovës.

- Fleksibile,
- Funksionale dhe objektive,
- Transparente dhe e ndershme,
- E respektueshme në afate,
- Krijuese e partneritetit dhe bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare,
- E gatshme për përmbushjen e detyrave në nivel më të lartë të përgjegjësisë,
- E vëmendshme në zbatim e metodave më të avancuara të trajnimit në përputhje me standardet bashkëkohore,
- Përmirësuese e kushteve të trajnimit për pjesëmarrësit,
- Efikase dhe racionale në shpenzimin e burimeve financiare.

FUNKSIONI DHE AKTIVITETET E IGJK-SË

Në bazë të ligjit, Instituti Gjyqësor i Kosovës është institucioni kryesor përgjegjës për:

I. Provimi Përgatitorë - IGJK-ja është përgjegjëse për vlerësimin dhe organizimin e provimit përgatitorë për personat të cilët synojnë të bëhen gjyqtarë ose prokurorë, të cilët para emërimit të tyre, si parakusht për përzgjedhje, duhet t'i nënshtrohen provimit përgatitorë.

II. Aftësimi i bartësve potencial të funksionit në gjyqësi - Programi Fillestar për Arsimim Ligjor - Ky program trajnues i kushtohet kandidatëve potencial që synojnë të bëhen gjyqtarë ose prokurorë në të ardhmen, të cilët pas Provimit Përgatitorë duhet ta ndjekin këtë program trajnues.

III. Aftësimi i bartësve të funksionit në gjyqësi - Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor - Ky program trajnues i kushtohet gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët janë duke ushtruar funksionin përkatës.


IV. Kurse të posaçme për avancimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve - Ky program trajnues i kushtohet gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët janë përzgjedhur për avancim.

V. Kurse për aftësim bazë të gjyqtarëve porotë - Ky program trajnues ju ofron gjyqtarëve porotë kurse trajnuese themelore.

VI. Kurse për aftësimin e profesionistëve të tjerë në lëmin e gjyqësisë të identifikuar nga IGJK-ja - Ky program trajnues përfshinë profesionistët të cilët konsiderohen të jenë ngushtë të lidhur dhe ndihmojnë funksionimin efikas të sistemit gjyqësor.

PROGRAMET E IMPLEMENTUARA NGA IGJK-JA

Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL) i dedikohet punës praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Qëllimi i këtij programi është të zhvilloj një plan-program trajnues afatgjatë i cili do të ndihmoj zhvillimin e aftësive dhe njohurive profesionale si dhe ndërtimin e reputacionit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë në lëmin e gjyqësisë. Qëllim tjetër i këtij



programi është edhe ndërtimi i aftësive të bartësve përkatës për të siguruar zbatimin unik të ligjit. Nga janari 2000 deri në tetor 2009 IGJK-ja ka mbajtur 617 sesione trajnuese:

- Gjatë 2000 IGJK ka mbajtur 24 sesione trajnuese
- Gjatë 2001 IGJK ka mbajtur 20 sesione trajnuese
- Gjatë 2002 IGJK ka mbajtur 42 sesione trajnuese
- Gjatë 2003 IGJK ka mbajtur 55 sesione trajnuese
- Gjatë 2004 IGJK ka mbajtur 52 sesione trajnuese
- Gjatë 2005 IGJK ka mbajtur 55 sesione trajnuese
- Gjatë 2006 IGJK ka mbajtur 63 sesione trajnuese
- Gjatë 2007 IGJK ka mbajtur 88 sesione trajnuese
- Gjatë 2008 IGJK ka mbajtur 96 sesione trajnuese
- Gjatë 2009 IGJK ka mbajtur 101 sesione trajnuese

Programi Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL) i dedikohet kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë. Objektivë e këtij programi është përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm para emërimit të tyre në këto pozita. Ky program trajnimi zhvillohet për një periudhë 15 mujore të ndarë në tri faza. PFAL ka filluar të zbatohet në shtator të vitit 2008 dhe gjenerata e parë përbëhet prej 30 kandidatëve. Gjenerata e dytë e PFAL ka filluar trajnimin në shtator të vitit 2009.